

Produkti i Brendshëm Bruto 1996 - 2008

Tiranë, më 08 Qershor 2016: INSTAT paraqet për përdoruesit të dhënat e serisë kohore mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) për të gjithë periudhën 1996-2008 në përputhje me metodologjinë e re të llogarive kombëtare ESA 2010.

Shqipëria si vend me status kandidat nisi implementimin e ESA 2010 gjatë vitit 2014, ku u rishikuan të dhënat e PBB-së për vitet 2008-2012, të publikuara më datë 31 Maj 2014. Siç ishte njoftuar dhe më parë, INSTAT do të vazhdonte punën për rishikimin e serive të mëparshme duke filluar që nga viti 1996, në përputhje me politikat e rishikimit të llogarive kombëtare. Rishikimet e PBB-së për shkak të përfshirjes së burimeve të reja të informacionit, ndryshimeve metodologjike ESA 2010 dhe klasifikimeve NVE Rev.2, konsiderohen revizionime të veçanta.

Kjo është faza e dytë e rishikimeve që i korrespondon pjesës tjetër të serisë së PBB-së vjetore 1996-2007 me çmime korrente dhe 1997-2008 me çmimet e vitit të mëparshëm sipas ESA 2010 dhe klasifikimit të aktiviteteve ekonomike NVE Rev.2. Pra, tashmë seria e të dhënave të PBB-së është e plotë nga viti 1996 deri në vitin 2014 sipas standardeve të reja ndërkombëtare.

PBB është rillogaritur sipas të dyja metodave, asaj të prodhimit dhe të shpenzimeve dhe rishikimet e serive kohore vjetore kanë arritur si rezultat i arsyeve të mëposhtme:

1. Përfshirja e burimeve të reja të të dhënave (Censusi i Popullsisë dhe i Banesave 2011, Censusi ekonomik i ndërmarrjeve jo-bujqësore 2010, të dhëna shtesë administrative dhe statistikore),
2. Implementimi i ESA 2010 në vlerësimet për sektorin financiar, llogaritjen e shërbimeve të ndërmjetësimit financiar të matura indirekt (FISIM) dhe shpërndarja e tij sipas sektorëve institucionalë, trajtimin e konsumit final të familjeve sipas COICOP 2 shifror, trajtimin e formimit bruto të kapitalit fiks sipas llojeve të aseteve, etj,
3. Implementimi i klasifikimit të aktiviteteve ekonomike NVE Rev.2,
4. Përmirësimi i teknikave statistikore dhe metodave të përpilimit të të dhënave për Llogaritë Kombëtare me çmime korrente dhe çmimet e vitit të mëparshëm.

Ndryshimet e sipërpërmendura kanë ndikuar në vlerësimet e PBB-së përgjatë gjithë serisë kohore 1996-2008 të cilat paraqiten në tabelat e mëposhtme. Për më shumë informacion lidhur me rishikimet e serive kohore vjetore dhe politikat e revizionimit të PBB-së, referojuni materialeve që gjenden në websitin e INSTAT me adresë: http://www.instat.gov.al/media/333395/part_a-gni_compilation_albania.pdf dhe

http://www.instat.gov.al/media/333415/Implementimi_i_esa_2010_dhe_nve_rev.2_n_llk_vjetore.pdf


Grupi i plotë i tabelave me të dhëna të hollësishme është në dispozicion në linkun e INSTAT me adresë:

<http://www.instat.gov.al/al/themes/llogarit%C3%AB-kombetare.aspx>

Tab1. PBB me çmimet e tregut 1996-2008

Vitet	Vlera e PBB me çmime tregu (në mln lekë)					
	PBB ESA 95 (në mln Lekë)	PBB ESA 2010 (në mln Lekë)	Ndryshimet në nivelin e PBB		Nga të cilat	
			në mln Lekë	në %	Implementimi i ESA 2010 (në pikë përqindje)	Përfshirja e burimeve dhe metodave të reja (në pikë përqindje)
1996	346.403	334.359	(12.044)	-3,48	2,77	-6,25
1997	346.198	331.324	(14.874)	-4,30	1,74	-6,03
1998	409.209	384.848	(24.360)	-5,95	1,40	-7,35
1999	471.578	443.594	(27.985)	-5,93	2,07	-8,00
2000	523.043	501.199	(21.844)	-4,18	2,19	-6,36
2001	583.369	563.449	(19.920)	-3,41	1,62	-5,03
2002	622.711	610.494	(12.216)	-1,96	1,46	-3,42
2003	694.097	677.738	(16.360)	-2,36	1,32	-3,68
2004	751.022	737.656	(13.366)	-1,78	1,76	-3,54
2005	814.797	804.163	(10.633)	-1,31	2,08	-3,38
2006	882.209	872.735	(9.474)	-1,07	2,65	-3,73
2007	967.670	965.528	(2.142)	-0,22	2,99	-3,21
2008	1.089.293	1.080.676	(8.617)	-0,79	2,96	-3,75
Mesatarja 1996-2008				-2,28	+2,18	-4,46


Fig 1. PBB 1996-2008, në milion Lekë



Tab2. Ndryshimet në ritjet reale të PBB 1997-2008

Vitet	Rritjet reale të PBB (në %)		
	PBB ESA 1995	PBB ESA 2010	Ndryshimet (në pikë përqindje)
1997	-10,84	-10,92	-0,16
1998	9,01	8,83	-0,12
1999	13,50	12,89	-0,37
2000	6,62	6,95	0,14
2001	7,94	8,29	0,07
2002	4,23	4,54	0,27
2003	5,74	5,53	-0,21
2004	5,67	5,51	0,38
2005	5,76	5,53	-0,31
2006	5,43	5,90	0,38
2007	5,91	5,98	-0,17
2008	7,54	7,50	0,17

Fig 2. Rritja reale e PBB 1997-2008, në %



Tab 3. PBB me metodën e prodhimit sipas ESA 2010, në milion Lekë

Viti	Prodhimi	Konsumi Ndërmjetës	Vlera e Shtuar Bruto	Taksa neto mbi produktet	PBB me çmimet e tregut
1996	532.562	219.745	312.817	21.542	334.359
1997	521.176	216.462	304.714	26.61	331.324
1998	615.211	276.057	339.154	45.694	384.848
1999	725.31	329.228	396.082	47.512	443.594
2000	827.052	384.926	442.127	59.072	501.199
2001	940.366	436.673	503.693	59.756	563.449
2002	1.020.717	477.94	542.778	67.717	610.494
2003	1.098.100	502.062	596.038	81.699	677.738
2004	1.223.709	576.17	647.539	90.117	737.656
2005	1.336.415	632.921	703.494	100.669	804.163
2006	1.449.012	693.748	755.265	117.47	872.735
2007	1.630.087	788.788	841.299	124.228	965.528
2008	1.866.114	929.196	936.917	143.759	1.080.676

Tab 4. PBB me metodën e shpenzimeve sipas ESA 2010, në milion Lekë

Viti	Vlerat me çmime korrente			PBB me çmime korrente
	Konsumi Final	Formimi Bruto i Kapitalit	Eksporti neto	
1996	346.366	60.398	-72.405	334.359
1997	359.062	55.197	-82.935	331.324
1998	405.863	75.979	-96.994	384.848
1999	432.915	87.542	-76.864	443.594
2000	463.244	154.351	-116.396	501.199
2001	500.543	197.143	-134.237	563.449
2002	557.807	215.285	-162.598	610.494
2003	619.648	229.732	-171.642	677.738
2004	652.2	252.254	-166.799	737.656
2005	707.476	296.492	-199.805	804.163
2006	769.319	311.545	-208.129	872.735
2007	890.645	332.74	-257.857	965.528
2008	1.010.137	360.64	-290.101	1.080.676

Tab 5. Konsumi final sipas ESA 2010, në milion Lekë

Vitet	Konsumi Final a+b+c	Konsumi Final i Popullatës (a)	Vlerat me çmime korente			
			Konsumi Final i Administratës Publike (b) = (i)+(ii)	Konsumi Individual (i)	Konsumi Kolektiv (ii)	Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse(c)
1996	346.366	314.054	31.609	11.495	20.114	703
1997	359.062	323.507	34.617	12.379	22.238	938
1998	405.863	363.085	41.734	15.823	25.912	1.044
1999	432.915	382.62	49.042	21.286	27.756	1.253
2000	463.244	413.162	48.578	23.642	24.936	1.504
2001	500.543	438.523	59.872	26.906	32.966	2.148
2002	557.807	486.152	69.2	28.345	40.855	2.455
2003	619.648	541.625	75.218	30.941	44.277	2.805
2004	652.2	566.336	82.661	33.819	48.842	3.204
2005	707.476	615.108	88.709	37.633	51.077	3.659
2006	769.319	673.236	91.875	40.566	51.309	4.208
2007	890.645	784.867	101.163	45.925	55.237	4.616
2008	1.010.137	892.776	112.163	52.376	59.787	5.198